



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 15/12/2020

Proces-verbal

Bashkia Korçë organizon një takim me përfaqësues të Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë, si dhe me administratorët dhe anëtarë të bordit në zonat TID dhe BID në Korçë, në kuadër të diskutimit për Paketën Fiskale të vitit 2021.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin Kletion Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë si dhe përfaqësues të biznesit të vogël dhe të mesëm, Albert Nasto kryetar i shoqatës së biznesit në rang vendi dhe Bujar Muço kryetar i shoqatës së biznesit për Korçën.

Viti 2020 ka patur një bashkëpunim shumë të mirë me përfaqësuesit e biznesit dhe shoqatat, duke bërë herë pas here konsultime mbi problematikat e kësaj situatë që shkaktoi Covid-19, me prioritet lehtësimin e barrës fiskale për biznesin.

Në këtë takim u diskutua për Paketën Fiskale të vitit 2021, evidentimin e sfidave për të ardhmen si edhe mundësinë për lehtësimin e tarifave në rast se do të duhet të ketë kufizime të tjera gjatë periudhës së pandemisë.

Gjatë takimit me përfaqësues të biznesit të vogël dhe të mesëm u evidentua bilanci pozitiv i Bashkisë së Korçës përsa i përket raportit regjistrim-çregjistrim. Një tjetër meritë e Bashkisë Korçë e cila doli në pah gjatë këtij takimi ishte formalizimi i biznesit. Kjo pasi të gjitha subjektet u vendosën në pozita të barabarta.

Ndër pretendimet kryesore të shoqatës së biznesit ishte rënia e fuqisë blerëse. Sipas tyre blerësit rritin kursimet dhe për pasojë vjen moskonsumimi i produkteve të tjera.

Gjatë vitit 2020 përfaqësuesit e biznesit vunë në pah vështirësitë që u hasën në bare, restaurante dhe hoteleri gjatë periudhës së karantinës, por nga ana tjetër u shprehën se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë ka punuar mirë dhe nuk ka pasur ankesa nga biznesi përsa i përket bashkëpunimit.

Përfaqësuesit e shoqatës së biznesit të vogël dhe të mesëm përgjatë këtij takimi listuan kërkesat e tyre për në vijim:

1. Nëse do të ketë, mbyllje të dytë (karantinë e plotë ose e pjesshme) të merret parasysh nga ana e bashkisë falja e tarifave për periudhën që nuk do të punojnë bizneset.
2. Falja e gjobave dhe kamtë-vonesave të vëna gjatë periudhës së pandemisë.
3. Kontrollë sa më të pakëta nga ana policisë dhe shmangia e gjobave.